

## KONKURS PËR GAZETARË

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, në partneritet me Organizatën për Fëmijë pa Kujdes Prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP, përmes projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim” financuar nga Bashkimi Europian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndan çmimet vjetore për tregimet më të mira në media, në fushën e mbrojtjes sociale dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, me fokus në të drejtat e fëmijëve në Kosovë, për vitin 2021.

Gjashtë çmime vjetore në gazetari, në vlerë prej 500 Euro secila, do të ndahen për shkrimet apo reportazhet më të mira të botuara në gazeta, portale, radio dhe televizione të ndryshme në Kosovë, gjatë vitit 2021.

### Aplikantët që konkurojnë duhet t'i përmbahen këtyre kriterëve:

1. Të kenë shkrim, botim, dokumentar apo reportazh televiziv/radiofonik që trajton tema të cilat kanë të bëjnë me fëmijët dhe ndërlidhen me shërbimet dhe mbrojtjen e tyre në Kosovë, **të botuara nga data 15 Nëntor 2020 deri në datën 14 Nëntor 2021;**
2. Të dërgojnë punimin / shkrimin / publikimin e tyre VETËM në formë elektronike me e-mail, në këtë adresë: [info@komfkosova.org](mailto:info@komfkosova.org).
3. Të bashkëngjisin në emailin ku aplikojnë, dy dokumente si më poshtë:
  - Të dhënat e aplikantit (emër, mbiemër, mediumi ku punon dhe numri i telefonit) së bashku me titullin e botimit, datën e saktë të publikimit të tij dhe vegëzën për qasje në artikull.
  - Punimin e plotë me të cilin aplikanti po konkuron.
4. Gazetarët kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se një botim / punim.

### Afatet për aplikim:

- Konkursi do të qëndrojë i hapur që nga data e shpalljes së tij në [www.portalpune.com](http://www.portalpune.com) dhe faqet zyrtare të KOMF, SOS dhe OFAP, **pra nga data 8 Nëntor 2021 deri më 28 Nëntor 2021, ora 00:00.**
- Çmimet për fituesit do të ndahen gjatë një ceremonie e cila do të organizohet gjatë muajit Dhjetor 2021.



### Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për çmimet vjetore:

Aplikimet e mbërritura në adresën zyrtare të KOMF do të kalojnë tre faza të vlerësimit; vlerësimin administrativ për të kontrolluar nëse dosja është e plotë, vlerësimin cilësor nga Komisioni i Pavarur i jashtëm për të përcaktuar fituesit dhe validimin e fituesve nga KOMF.

**FAZA 1:** Në fazën e vlerësimit administrativ të aplikimeve të mbërritura, do të shqyrtohen:

- 1 Aplikimi është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në thirrje.
- 2 Dosja e aplikimit është e plotë (sikurse ceket tek kriteret).
- 3 Aplikimi është dorëzuar me email.

**FAZA 2:** Në fazën e vlerësimit cilësor nga Komisioni i Pavarur i jashtëm, do të shqyrtohen:

- 1 Rëndësia e shkrimit/botimit/artikullit.
- 2 Ndikimi në përmirësimin e pozitës së fëmijëve në shoqëri.
- 3 Struktura e shkrimit/botimit/artikullit dhe llojshmëria e burimeve.
- 4 Respektimi i parimeve etike dhe standardeve profesionale gjatë raportimit për fëmijë.

**FAZA 3:** Punimet e zgjedhura nga Komisioni i Pavarur i jashtëm do të nënshtrohen shqyrtimit dhe validimit si fitues nga paneli i KOMF, i cili do të vlerësojë:

- 1 Nëse ato janë në përputhje me të gjithë standardet.
- 2 Nëse ato janë në përputhje me të gjitha procedurat.
- 3 Nëse ato janë në përputhje me të gjithë parimet e mbrojtjes së fëmijëve.

KOMF, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP inkurajojnë të gjithë gazetarët që kanë punuar shkrime apo reportazhe të të gjitha trajtave, të cilat trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, dhe të cilat kanë synuar dhënien e kontributit në përmirësimin e mbrojtjes sociale dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, të aplikojnë për gjashtë çmimet e mëdha që do të ndahen këtë vit.

